
	<p align="center">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p align="center">Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	<p align="center">PRISHTINA</p> 
---	---	---

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 18.03.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: Petra Plast L.L.C., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”**, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1, Autoriteti Publik - Komuna e Prishtinës me datë: 20.03.2023 nxjerr:

V E N D I M

- Hudhet poshtë si e palejuar kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: Petra Plast L.L.C. e parashtruar me datë: 18.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të AK –së, të datës 10.02.2022 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së , në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.**
- Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin për të vazhduar lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1.**
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>**



ARSYETIM

Operatori Ekonomik ankimor Petra Plast L.L.C. ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim me datë: 18.03.2022 kundër njoftimit për kontratë të datës: 10.02.2023, ku në kërkesën për rishqyrtim e cila është jashtë afatshme dhe poashtu nuk ka paraqitur asnjë pretendim ankimor, Autoriteti Publik në zbatim të nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik i cili thekson si në vijim:

Neni 108/A

Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

1. *Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.*

3. *Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:*

3.1. *në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;*

Operatori Ekonomik ankimor ka humbur të drejtën e tij për ushtrimin e mjetetit juridik në bazë të nenit 3 par.3.1 pasi që i ka kaluar afati prekluziv për paraqitjen e mjetetit juridik.

Poashtu ky Operator Ekonomik ushtrimin e veprimtarisë së tij biznesore e ushtron si në vijim:

zyjeur... zyjeur...

Petra Plast L.L.C.

Emri i biznesit	Petra Plast L.L.C.
Emri tregtar	Petra Plast
Lloji biznesit	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
Numri unik identifikues	811857351
Numri i biznesit	///
Numri fiskal	///
Numri certifikues KTA	///
Numri punëtorëve	8
Data e regjistrimit	02/09/2021
Komuna	Prishtinë
Adresa	Prishtinë, Rruga Ahmet Krasniqi, .
Telefoni	+38348226227
E-mail	iqader_1@yahoo.com
Kapitali	20,000.00€
Statusi në ARBK	Regjistruar
Statusi në ATK	///

- Menju**
- Lista e bizneseve
 - Bollina
 - Agjencia
 - Sektori i Pengut
 - Legjislacioni
 - Dokumentet
 - Sektori i Pengut
 - Raportet
 - Media
 - Kontakti
 - Vezat**

Perfaqësues i autorizuar

Emri	Mbiemri	Pozita në biznes	Autorizimet
IBRAHIM	A. A. ABUESMAIL	Drejtor menaxhues	Sipas ligjit dhe statutit.

Pronar/ Aksionarë

Emri Mbiemri	Kapitali në €	Kapitali në %
Ibrahim A. A Abuesmail	10,000.00€	50.00%
Mohammad Reyad KH. A. Alnajjar	10,000.00€	50.00%

Njësitë

Nr	Numri i njësitë	Emri	Vendi
----	-----------------	------	-------

Aktivitet/et

Kodë	Përshkrimi	Tipi
2221	Prodhimi i pflakëzave të plastikës, fletëzave, tubave dhe profiëve	Primarë
2222	Prodhimi i artikujve të plastikës për paketim	Tjera
2223	Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtarë	Tjera
2229	Prodhimi i produkteve të tjera të plastikës	Tjera
2829	Prodhimi i makinerive të tjera me përdorim të përgjithshëm të p.k.t.	Tjera
4590	Tregtia me shumicë jo e specializuar	Tjera
4778	Tregtia me pakicë e mallrave të tjera të reja, në dyqane të specializuara	Tjera
4941	Transporti ruqor i mallrave	Tjera

Pra të gjitha aktivitetet e këtij operatori nuk lidhen dhe nuk kanë të bëjnë fare me pastrimin e objekteve dhe si rezultat tendenca e këtij operatori ekonomik është që të pengoj aktivitetin e prokurimit publik përmes ushtrimit të mjetit juridik për penguar përmes lajthimit dhe mashtrimit të cilat cilësohen vepër penale.

Autoriteti Publik në bazë provave dhe argumenteve si dhe dispozitave ligjore do të ndërmarr masa ndëshkuese për operatorët të cilët pengojnë qëllimshëm aktivitetet e prokurimit për të dëmtuar procesin e prokurimit publik në mënyrë të kundërligjshme.

Andaj duke u bazuar në bazë të asaj që është lartcekur Autoriteti Publik vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Iu dorëzohet:

Departamentit të Prokurimit

Palës përmes sistemit elektronik - E-Prokurimi

Arkivit

Visar Shehu – U.D. – Departamenti i Prokurimit

